



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.18/2020

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, Diellza Hoxha dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit, në çështjen disiplinore ndaj **.....**, si organ përmbardues, e emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e **.....**, e dyshuar për shkelje disiplinore lidhur me veprimet përmbardimore në lëndën përmbardimore P. nr 792/19, pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike me datën 20.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, DPL-18/2020, datë 09.10.2020, dhe ankesa e palës ankuese, datës 21.09.2020, si të pa bazuara.
- II. Organi përmbardues-! **.....** nuk është përgjegjëse për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbardimore P. nr 792/19.

A r s y e t i m

Me datën 21.09.2020, përkatësisht më datën 29.09.2020 pala ankuese, **.....**, ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj **.....**, si organ përmbardues, e emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin **.....**, për shkelje disiplinore sepse ka tejkalluar autorizimet e saj dhe gjatë kryerjes se veprimeve në kuadër të aktivitetit të saj nuk i është përmbajtur ligjit, siç kërkohet sipas dispozitave të nenit 367 të LPP-së. Pala ankuese pretendon që përmbarduesja private në kundërshtim me dispozitat ligjore mbi dërgimin e shkresave, pa asnjë paralajmërim, ka bllokuar

llogarinë dhe parcelat. Shton se asnjëherë nuk kishte pranuar propozimin për përmbarim deri me dt 29.09.2020. Sipas palës ankuese, ishte sjellje arrogante ndaj palës ankuese kur pala ankuese ishte paraqitur në zyrën e saj për të kërkuar informata lidhur me këtë lëndë.

Me datën 09.10.2020, Ministria e Drejtësisë -Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komision propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj r" lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën P. nr 792/19.

i përgjigjen e saj me shkrim deklaroi që të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë çështje janë ndërmarr në pajtim me dispozitat ligjore dhe autorizimet që dalin nga ligji. Lidhur me pretendimin e debitorit-këtu palës ankuese se përmbaruesi nuk i kishte dërguar shkresat dhe nuk e kishte njoftuar, përmbaruesja private deklaroi që propozimin dhe urdhërin përmbarimor ia ka dërguar palës ankuese në adresën elektronike dhe si dhe përmes Postës së Kosovës në adresën e debitorit: Bërnice e Poshtme, p.n. 10000 Prishtinë. Tutje, përmbaruesja private deklaroi se me dt 18.01.2020 ka pranuar fletëkthesën nga Posta e Kosovës ku është theksuar që "marrësi nuk jeton në Bërnice kurse me telefon nuk vjen me marr shkresën dt 03.01.2020." Sipas përmbarueses private ishin ndërmarr veprime shtesë duke kërkuar adresën e palës ankuese në faqen zyrtare të ATK dhe regjistrin e llogarive bankare dhe në të gjitha burimet e informacioneve është shfaqur e njëjta adresë. Thekson që ajo ka njoftuar menjëherë palën kreditore lidhur me çështjen e adresës dhe pastaj ka vazhduar me afishimin e shkresave të lëndës në tabelën e shpalljeve në zyrën e saj, në bazë të nenit 18 të LPP.

Me datën 25.08.2020, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, në cilësi të inicuesit të procedurës disiplinore. Pala ankuese ka njoftuar Komisionin se nuk mundet të prezentojë në seancë për shkak të një udhëtimi jashtë vendit. Poashtu, nuk ka prezentuar as cila ka theksuar që nuk mund të marrë pjesë për shkak të situatës me pandeminë COVID-19.

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, ka bërë shtjellimin e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj r" duke theksuar se bazuar në ankesën e parashtruar nga pala ankuese ka bërë shkelje disiplinore me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore në lëndën P.nr 792/19 duke shkelur ligjin dhe tejkaluar autorizimet ligjore.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të këtij vendimi është vërtetuar në mënyrë drejtë dhe të saktë dhe se përmbaruesja private nuk ka kryer vepër disiplinore.

Komisioni gjen se kishte ndërmarrë veprime për të siguruar adresën e saktë të palës debitore. Fakti se rrugët nuk përmbajnë emra dhe numra të saktë të adresave, nuk mund t'i atribuohen përmbarueses private si lëshime. kishte kërkuar informacione lidhur me adresën e palës ankuese në disa burime, siç vërtetohet edhe nga provat në shkresat e lëndës. Saktësisht në atë adresë të palës ankuese cila është e regjistruar në të dhënat e ARBK-së ishin dërguar shkresat e lëndës nga ana e përmbarueses private. Në fletëkthesë theksohet që *“marrësi nuk jeton në fsh Bërrnicë kurse me telefon nuk vjen më marrë ftesën.”* Vet pala ankuese nuk kishte shprehur kujdes të duhur për të ofruar informata zyrtarëve të Postës së Kosovës kur ishte kontaktuar lidhur me dokumentet të cilat ata përpiqeshin t'ia dërgonin atij. Pala ankuese kishte mundësi të mjaftueshme të ishte bashkëpunues dhe t'ua ofronte të dhënat e sakta të adresës së tij zyrtarëve të Postës në mënyrë që të siguronte shkresat e adresuara atij por ai këtë nuk e kishte bërë. Përmbaruesja private ishte mbështetur pikërisht në këto informacione të ofruara nga Posta e Kosovës. Ato ishin zyrtare dhe të besueshme. Tutje, ishte ndërmarrë edhe veprime shtesë duke kontrolluar të dhënat lidhur me adresën e palës ankuese edhe në ATK dhe Regjistrin e Llogarive Bankare, dhe, në të gjitha burimet e informimit, adresa rezultonte e njëjtë për palën ankuese. Vetëm pasi gjitha përpjekjet e përmbarueses private për të siguruar informata shtesë kishin rezultuar të pasukseshme, kishte bërë afishimin e shkresave të lëndës në tabelën e shpalljeve në zyrën e saj. Gjykata gjen se veprimet e përmbarueses ishin plotësisht në pajtim me ligjin.

Sa i përket sjelljes arrogante nga ana e përmbarueses private, Komisioni nuk gjen asnjë provë e cila në mënyrë të arsyeshme mbështet një pretendim të tillë. Vetëm fakti se pala ankuese nuk pajtohet me procedurën përbarimore nuk e bënë veprimin e përmbarueses private arrogante. Përmbaruesja private i ka siguruar dokumentacionin palës ankuese posa ishte paraqitur dhe kishte kërkuar atë. Pala ankuese kishte mundësi të ushtronte prapësim nëse konsideronte që të drejtat e tij ishin afektuar nga veprimet e përmbarueses private, të cilën edhe e ka bërë. Është çështje e gjykatës kompetente të vendos lidhur me pretendimet ligjore të ngritura nga ana e palës ankuese. Procedurat disiplinore pranë këtij komisionin nuk janë procedura shtesë të procedurave gjyqësore apo zëvendësuese të tyre ku palët adresojnë pretendimet ligjore për të cilat parimisht vendos gjykata.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 18/2020, datë 20.11.2020

Kryesuesi i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUF



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.